

KONTRATE

PER THEMELIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ALB BB REVIZION"

Palet kontraktuese;

Baki Berberi, Ekspert Kontabel i Autorizuar, i paisur me licensen nr.1 date 10.02.2000, banues në Tiranë, Rruga Muhamet Gjollësja, pall. 1/1, shk. 1, ap. 10.

Peri Buzali, Ekspert Kontabel i Autorizuar, i paisur me licensen nr. 33 date.10.02.2000, banues në Tiranë, Rruga e Durrësit, pall. 228, Shk. 1, Ap 10.

Ne mbështetje të ligjit nr,7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" me ndryshimet e bera me ligjin nr. 7953 date 22.6.1995 si dhe të dispozitave të tjera të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë u morem vesh si më poshtë;

Neni 1

Te themelojme një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për të ushtruar veprimtari të përbashkët profesionale në fushën e Ekspertizave kontabel dhe kontrollin ligjor të llogarive. Shoqëria ka selinë e vetë në Tiranë në adresën Rruga Myslym Shyri, Pall. 8, Ap. 10.

Neni 2

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do quhet "Alb BB Revizion". Ajo është person juridik i së drejtës shqiptare, që ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me këto kontrate me statusin e saj dhe me legjislacionin shqiptar. Statuti i shoqërisë i bashkelidhet kësaj kontrate dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 3

Shoqëria ka për **objekt kryerjen e misionëve të kontrollit ligjor të llogarive dhe të ekspertizave kontabel**. Ajo mund të kryejë çdo operacion të pajtueshëm me objektin e saj dhe që lidhet me këtë objekt duke përjashtuar çdo operacion apo veprimtari që do tentonte t'a shmangte shoqërinë nga karakteri profesional. Shoqëria mund të zotërojë pjesëmarrje financiare në shoqëri të tjera të eksperteve kontabel, por pa i bërë këto pjesëmarrje objekt kryesor të veprimtarisë së saj.

Neni 4

Shoqëria përgjigjet për detyrimet ndaj të tjerëve vetëm me pasurinë e saj. Ajo nuk përgjigjet në asnjë rast për detyrimet personale të ortakeve. Ortaket nuk përgjigjen

personalisht per detyrimet e shoqerise dhe nuk perballojne humbjet e saj pertej shumes se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 200,000 leke i ndare ne 20 pjesë me vlerë nominale 10,000 secila.

Neni 6

Ortakët marrin pjesë ne kapitalin themeltar te shoqerise me kontributet e tyre ne para si me poshte;

- a) Baki Berberi 10 pjesë, nga nr 01 deri në 10, me shumën 100,000 leke, që përbëjnë 50% të kapitalit themeltar të shoqërsisë,
- a) Peri Buzali 10 pjesë, nga nr 11 deri në 20, me shumën 100,000 leke, që përbëjnë 50% të kapitalit themeltar të shoqërsisë..

Shumat ne para te kapitalit themeltar te shoqerise ne themelim e siper jane depozituar ne banken Amerikane të Shqipërisë në Tirane. Shumat e depozituara vertetohen me certifikaten e leshuar nga banka.

Neni 7

Ortakët detyrohen te ruajne sekretin e dokumentacionit te shoqerise qe ka te beje me informacionin dhe pervojen e grumbulluar te shoqerise, te dhena qe i perkasin asaj si edhe klienteve te shoqerise. Ortakët jane përgjegjes per demet qe mund te rrjedhin nga mosrespektimi i ketyre detyrimeve..

Neni 8

Shoqeria e fillon veprimtarine e saj nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar.

Neni 9

Fitimi neto i shoqerise pasi te jene hequr shumat per rezerven e domosdoshme dhe rezervave te tjera te vendosura nga asambleja,u ndahet ortakeve perpjesetimisht me kuotat e tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 10

Organet e shoqerise jane:

- a)Asambleja e ortakeve
- b)Administratori i vetëm

Funksionet e tyre përcaktohen në statutin e shoqërisë. Brenda një muaji nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregëtar do të thirret Asambleja e ortakëve për të emëruar administratorin e vetëm dhe për të emëruar Ekspertin kontabel të autorizuar.

Neni 11

Kjo kontratë lidhet për një periudhë 10 vjeçare, e ripërtëritëshme. Kjo periudhë mund të zgjatet ose të shkurtohet me vendim të asamblesë të ortakëve. Kjo kontratë si dhe dokumentet përkatës bashkëlidhur përfaqësojnë vullnetin e lirë e të plotë të palëve. Ajo mund të ndryshohet me një marrëveshje të re, me shkrim, duke e njoftuar një vendim të tillë 6 muaj përpara.

Neni 12

Mosmarrëveshjet eventuale që mund të lindin midis palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me pajtim dhe kur kjo nuk arrihet, nga gjykata kompetente Shqiptare.

Neni 13

Dispozita të hollësishme për shoqërinë përcaktohen në statutin e saj që i bashkëlidhet kësaj kontrate.

Neni 14

Kjo kontratë u hartua në 5 ekzemplarë origjinale në gjuhën shqipe. Kontrata u hartua në Tiranë më 18.03.2000 dhe përmban 14 nene.

Nënshkruesit

Baki Berberi



Peri Buzali



STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ALB BB REVIZION"

Ne neshkruesit ;

Baki Berberi, i datëlindjes 10.01.1942 i martuar e me dy fëmijë, i regjistruar në listën e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar me nr. 1, banues, banues në Tiranë, Rruga Muhamet Gjollësia, pall. 1/1, shk. 1, ap. 10.

Peri Buzali, i datëlindjes 28.09.1948, i martuar me dy fëmijë, i regjistruar në listën e Institutit të Ekspertëve kontabël të Autorizuar me nr. 33, banues në Tiranë, Rruga e Durrësit, pall. 228, Shk. 1, Ap 10.

kemi hartuar sic vijon me poshte statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te themeluar me kete akt;

KREU 1 Dispozita të Përgjithshme

Neni 1: Forma

Midis pronareve te pjeseve ne kapital te krijuara si me poshte dhe te gjithe pronareve te pjeseve qe mund te jene me pas ekziston nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e rregulluar nga ligji "Për shoqerite tregëtare", nga rregullat per profesionin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe nga ky statut .

Neni 2 Emertimi

Emertimi i shoqerise eshte ALB BB Revizion sh.p.k. Shoqeria do te jete e regjistruar ne listen e Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar me emertimin e saj. Aktet dhe dokumentet qe dalin nga shoqeria dhe qe destinohen per te tretet, pikerisht letrat, faturat, njoftimet dhe publikimet e ndryshme permbajne jo vetem emertimin e saj te ndjekur nga shkronjat SH P. K. por ky emertim ndiqet nga permendja "shoqeri e ekspertizes kontabel dhe kontrollit ligjor te llogarive "dhe nga tregimi i numrit te listes te institutit ku eshte regjistruar.

Neni 3-Objekti

Shoqeria ka per objekt kryerjen e misioneve të kontrollin ligjor të llogarive dhe të ekspertizave kontabël. Ajo mund të kryejë çdo operacion të pajtueshëm me objektin e saj dhe që lidhet me këtë objekt duke përjashtuar çdo operacion apo veprimtari që do tentonte t'a shmangte shoqërinë nga karakteri profesional. Shoqeria mund te zoteroje pjesemarrje financiare ne shoqeri te tjera te eksperteve kontabel, por pa i bere keto pjesemarrje objekt kryesor te veprimtarise se saj.

Neni 4 Vend ndodhja e selise te shoqerise dhe vendbanimi apo selia e ortakeve.

Shoqeria e ka seline zyrtare ne Tirane në Rrugën Myslym Shyri, Pall. 8, shk. 3, Ap 10. Shoqeria me vendim te asamblese te ortakeve mund te ndryshoje vend ndodhjen e selise zyrtare te shoqerise, te hape dhe te mbyllë filiale, dege ose zyra perfaqesimi ne te gjithë teritorin e Republikës se Shqiperise. Vendbanimi i ortakeve persona fizike ose selia e ortakeve persona juridike per sa i perket marrredhenieve te tyre me shoqerine eshte ai qe shenohet ne librin e ortakeve.

Neni 5. Kohezgjatja e shoqerise.

Kohezgjatja e shoqerise caktohet 10 vjet, nga data e regjistrimit ne regjistrin tregetar. Asambleja e jashtezakonshme me propozimin e secilit ortak mund te vendose zgjatjen e ketij afati ose prishjen e shoqerise perpara mberritjes se ketij afati.

Neni 6. Pergjegjesia e shoqerise.

Shoqeria pergjigjet per detyrimet e saj ndaj te treteve vetem me pasurine e saj. Ajo nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve te saj. Ortaket nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise ndaj te treteve dhe per humbjen e saj vecse ne masen e vleres nominale te pjeseve ne kapitalin themeltar.

Kreu 2: Dispozitat për Kapitalin

Neni 7 Kapitali themeltar.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 200,000 leke. Ai është i ndarë në 20 pjesë me vlerë nominale 10,000 secila. Ortaket marrin pjese ne kapitalin themeltar te shoqerise me kontributet e tyre ne para si me poshte;

- a) Baki Berberi 10 pjesë, nga nr 01 deri në 10, me shumën 100,000 leke, që përbëjnë 50% të kapitalit themeltar të shoqërsisë,
- b) Peri Buzali 10 pjesë, nga nr 11 deri në 20, me shumën 100,000 leke, që përbëjnë 50% të kapitalit themeltar të shoqërsisë.

Kontributet e secilit ortak jane regjistruar ne librin e llogarive dhe ne regjistrin e posacem te shoqerise.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane te shlyera teresisht nga ortaket ne pajtim me aktin e themelimit (kontrata) te shoqerise. Fondet e ardhura nga shlyerja e pjeseve jane depozituar në Bankën Amerikane të Shqiperisë në Tiranë në llogarinë bankare Nr. 4121-70-40 në datën 13.03.2000.

Neni 8 Ndryshimi i kapitalit themeltar

Me miratim te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve shoqeria ka te drejte te zmadhoje ose zvogeloje kapitalin themeltar, ne pajtim me ligjin. Ne rastin e nje zmadhimi te kapitalit ortaket kane te drejte te heqin dore individualisht nga e drejta e nenshkrimit te pjeseve te kapitalit

Neni 9. Ortaket e shoqerise.

Ortaket e shoqerise, eksperte kontabel te autorizuar te quajtur ne vijim ortake profesioniste do te jene ne cdo rast te pakten tre te katertat e numrit te ortakeve gjithsej dhe do te zoterojne jo me pak se tre te katertat e kapitalit themeltar. Shoqeria i komunikon cdo vit keshillit te drejtimit te IEKA listen e ortakeve te saj si dhe cdo ndryshim te kesaj liste. Kjo liste mbahet ne dispozicion te organeve te pushteteve publike dhe te cdo te treti te interesuar.

Neni 10 Pergjegjesia e ortakeve profesioniste.

Ne misionet apo punet qe kryen per klientet e vet shoqeria perfaqesohet nga nje ortak profesionist. Ortaket profesioniste marin persiper ne cdo rast pergjegjesine e puneve dhe te veprimtarise se tyre. Pergjegjesia e vet shoqerise lejon te ekzistojte pergjegjesia personale e cdo ortaku profesionist per shkak te puneve qe ky i fundit kryen per llogari te shoqerise.

Neni 11. Eskluziviteti i shoqerise mbi ortaket profesioniste

Ortaket profesioniste nuk mund te kryejne veprimtari profesionale as ne emer dhe per llogari te tyre dhe as ne emer e per llogari te nje shoqerie tjeter ekspertesh kontabel te autorizuar. Megjithate ne rastet kur emerimi individualisht i nje ortaku te shoqerise eshte i kerkuar nga legjislacioni apo vete klienti me pelqimin paraprak te administratorit ai mund te pranoje misionin. Ne kete rast ortaku i jep mandat shoqerise per arketimin e honorareve nga klienti.

Neni 12. Perjashtimi i nje ortaku profesionist.

Ortaku profesionist qe pushon se qeni i regjistruar ne listen e IEKA pushon nga kryerja e cdo veprimtarie e profesionale ne emer te shoqerise nga data e hyrjes ne fuqi te vendimit. Ne qoftese largimi i tij ka si efekt pakesimin e pjeseve te kapitalit te zoteruara nga ekspertet kontabel te autorizuar poshte kuotes se kerkuar nga ligji ai ka nje afat prej 6 muajsh duke u nisur nga e njejta date per te transferuar pjeset e tij ne nje mase te tille qe i mundeson shoqerise te respektojte kete kuote. Ai mund te kerkoje riblerjen nga shoqeria te teresise te pjeseve te tij. Çmimi i shitjes caktohet ne rast mosmarreveshje ne pajtim me nenin 11 te ligjit.

Neni 13 Terheqja e ortakeve dhe pranimi i ortakeve te rinj.

Çdo ortak qe kerkon te tërhiqet nga shoqeria duhet t'a motivoje kete terheqje perpara asamblese se ortakeve me anen e nje kerkese me shkrim. Ortaku qe kerkon te terhiqet nga shoqeria duhet t'ua afroje pjeset e tij per blerje ortakeve ekzistues. Kur keta te fundit nuk deshirojne te ushtrojne te drejten e parablerjes se pjeseve ortaku qe terhiqet ka te drejte t'ua shese ato te treteve, jo ortake te cilet duhet te miratohen paraprakisht nga asambleja e ortakeve e cila zbaton te gjitha kerkesat e ligjit Për Shoqerite Tregetare. Transferimi i pjeseve te kapitalit themelor vertetohet me akt noterial. Shitja e pjeseve te kapitalit themeltar personave te trete jo ortake nuk mund te kryhet me kushte me te favorshme nga ato qe u jane afruar me pare ortakeve. Terheqja nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet e tij te meparshme ndaj shoqerise ,dhe as shoqerine nga detyrimet e meparshme kundrejt ortakut.

Neni 14.Humbja e cilesise se ortakut

Cilësia e ortakut humbet;

a. kur atij i hiqet apo i pezullohet licensa per ushtimin e profesionit nga autoriteteti, i njohur sipas legjislacionit ne fuqi.

b. kur deklarohet i padenje per shkak te veprimeve konkuruese te pasinqerta per shkelje te rregullave te profesionit ,per perhapje te dokumentave ose sekreteve zyrtare te shoqerise ,

c.kur falimenton.

Neni 15 Vdekja e ortakut, person fizik, ekspert kontabel i autorizuar.

Ne rast vdekje te nje ortakut te shoqerise, person fizik ekspert kontabel i autorizuar, trashegimtaret e tij kane nje afat prej dy vjetesh per t'i shitur pjeset ne kapital tek nje ekspert kontabel i autorizuar per te cilin eshte dhene miratimi paraprak nga shoqeria sipas kushteve te përcaktuara ne nenin 14 te ketij statuti.

Kreu i Trete: Dispozita per financat dhe kontabilitetin

Neni 16 Veprimtaria e shoqerise

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne baze te parimeve ekonomike dhe me respektimin e legjislacionit ne fuqi dhe te rregullave te profesionit. Veprimtaria financiare e shoqerisë realizohet sipas programeve vjetore të miratuara nga asambleja e ortakëve. Veprimtaria financiare e shoqerise dhe rezultatet e saj pasqyrohen ne llogarite e shoqerise dhe ne raportin e administratorit.

Neni 17 Viti financiar.

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31. Dhjetor.Perjashtimisht viti i pare financiar kur dote qe te nise veprimtaria e shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor

Neni 18 .Fondet rezerve

Nga fitimet e cdo viti financiar pasi te jene zbritur kur eshte rasti humbjet e mbartura ,do te hiqen jo me pak se pese perqind per rezerven e domosdoshme deri sa shuma e kesaj rezerve te arrije nje te dhjeten e kapitalit themeltar. Asambleja e ortakeve ka te drejte qe nga fitimet e cdo viti financiar te krijojte rezerva te posacme duke percaktuar shumen dhe qellimin e perdorimit te tyre.

Neni 19 Dividendët

Fitimi neto i cdo viti financiar, pasi te jene zbritur shumat per rezervat ndahet me vendim te ortakeve si dividend midis ortakeve ne perpjesetim me pjeset e tyre ne kapitalin themeltar. Asambleja e ortakeve ka te drejte te vendose per ndarjen si dividend te rezervave te lira qe ka ne dispozicion ne rastet kur pjeset nga fitim nuk jane te kenaqeshme per ortaket.

Neni 20 Kontabiliteti dhe pasqyrat financiare vjetore

Shoqeria mban nje kontabilitet te rregullt dhe ne pajtim me kerkesat e legjislacionit ne fuqi. Ne mbyllje te cdo viti financiar administratori harton inventarin e pasurise te shoqerise ne kete date si dhe pasqyrat financiare vjetore (llogarite vjetore),te cilat bashke me raportin vjetor te administrimit i paraqiten per shqyrtim e miratim asamblese te ortakeve, brenda dates 31 mars te vitit qe pason vitin financiar te mbyllur.

Kreu 4: Administrimi dhe kontrolli i shoqerise.

Asambleja.

Neni 21 Perberja e asamblese.

Asambleja e ortakeve eshte autoriteti me i larte drejtues i shoqerise. Ajo formohet nga te gjithet ortaket pavaresisht nga numri i pjeseve ne kapitalin themeltar qe zoterojne. Sipas natyres te vendimeve te shoqerise qe eshte thirrur per te marre, asambleja eshte e zakonshme ose e jashtezakonshme. Asamblete kryesohen nga nje anetar, i zgjedhur nga ortaket .Kryetari i asamblese emerone nje sekretar qofte dhe jo ortak.

Neni 22 Asambleja e zakonshme ;

Asambleja e zakonshme e ortakeve vendos ;

-per miratimin ose mos miratimin e llogarive vjetore te shoqerise

-per emerimin ose zevendesimin dhe shperblimin e administratorit te vetem ose te adminstratoreve

-per direktivat strategjike per veprimtarine e shoqerise

Asambleja e zakonshme thirret te pakten nje here ne vit me paralajmerim me shkrim,duke perfshire ketu dhe rendin e dites ,te derguar me leter rekomande me pergjigje ne adresen qe shenohet ne librin e ortakeve.

Asambleja e zakonshme merr vendime të vlefshme kur ortaket e pranishëm dhe të përfaqësuar zënë jo më pak se dy të tretat e pjesëve të kapitalit themeltar. Cdo ortak mund të përfaqësohet në asamble nga një ortak tjetër që nuk është administrator ose nga një jo ortak por që nuk është i punësuar i shoqërisë. Cdo ortak ka aq vota sa ka pjesë në kapitalin themeltar. Asambleja e zakonshme vendos me shumicë votash. Në rast votash të barabarta, vota e kryetarit të asamblese është përcaktuese. Asambleja e zakonshme mund të jetë plotësisht e vlefshme edhe kur është thirrur pa paralajmërim me kusht që të jenë të pranishëm të gjithë pjesët e kapitalit themeltar.

Neni 23 Asambleja e jashtëzakonshme.

Asambleja e jashtëzakonshme e ortakeve vendos për ;

- a) ndryshimet në statut;
- b) shtimin ose pakesimin e kapitalit themeltar;
- c) zgjatjen e shkurtimin e afatit të shoqërisë;
- d) pushimin e veprimtarisë së shoqërisë;
- e) transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar të treta jo ortake;
- f) transformimin e shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në formë të tjera të shoqërisë;

Asambleja e jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm kur ortaket e pranishëm dhe të përfaqësuar zotërojnë jo më pak se tre të katërtat e kapitalit themeltar. Vendimet merren me të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar të pranishme në asamble nga ortaket e pranishëm dhe të përfaqësuar në rast se nuk përcaktohet ndryshe në ligjin Për shoqëritë Tregtare..

Neni 24 Procesverbalet

Procesverbalet e asamblese të zakonshme apo të jashtëzakonshme, hartohen nga sekretari dhe kundërfirmohen nga kryetari i asamblese. Në procesverbalet e asamblese të zakonshme apo të jashtëzakonshme, duhet të pasqyrohen qoftë edhe me një kërkesë të një ortaku të vetëm deklaratat e tij.

Administratoret.

Neni 25

Numeri dhe emerimi;

Shoqëria administratohet nga një administrator, ortak i cili duhet të jetë ekspert kontabel i autorizuar. Administratori emërohet nga asambleja e zakonshme për tre vjet. Ai mund të riemërohet. Asambleja e ortakeve përcakton edhe shpërblimin e administratorit. Ju propozua si që të bëhet administrator njerit prej ortakeve, zotit Peri Buzali, dhe ai e pranoi këtë detyrë. Atij ju ngarkua edhe detyra që të kryejë të gjitha veprimet zyrtare të krijimit të shoqërisë.

Neni 26 Kompetencat e administratorit

Administratori ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer dhe per llogari te shoqerise ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe ky statut ja njohin shprehimisht asamblese se ortakëve.

Kompetencat eskuzive te administratorit jane keto qe vijojne;

- te organizoje veprimtarine e shoqerise me qellim qe te realizohen programet e saj
- te siguroje administrimin e shoqerise
- te perfaqesoje shoqerine ne marredhenie me te tretet
- te perfaqesoje shoqerine perpara autoriteteve gjyqesore, arbitrale dhe administrative
- te administroje pasurine dhe mjetet financiare te shoqerise brenda caqeve te caktuara nga asambleja e ortakëve
- te leshoje prokura per nepunsit e shoqerise dhe pergjithesisht per te tretet

Kreu i V: Transformimi, prishja e likuidimi i shoqërisë dhe mosmarrëveshjet

Neni 27 Transformimi i shoqërisë

Transformimi i shoqërisë nga një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në një shoqëri anonime bëhet me miratim të ortakëve që zotërojnë më shumë se tre të katërat e kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 28 Prishja e shoqërisë

Shoqëria priset e shpërndahet:

- a) Me mbarimin e afatit të kohëzgjatjes së saj;
- b) Në rast kur nuk ka mundësi të realizohet objekti i saj;
- c) Me miratimin e të gjithë ortakëve.

Neni 29 Likuidimi

Likuidimi i shoqërisë kryhet sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi në momentin e likuidimit. Me prishjen e shoqërisë për çfarëdo lloj shkaku asambleja e jashtëzakonshme emëron një ose më shumë likuidatorë, ortakë ose jo ortakë, përcakton kompetencat dhe shpërblimin e tyre si dhe mënyrat e likuidimit.

Neni 30: Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë midis ortakëve do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në mungesë të arritjes së mirëkuptimit, do të zgjidhen nga gjykatat kompetente shqiptare.


Neni 31 Numri i kopjeve të statutit dhe gjuha

Ky statut i përbërë nga 31 nene është hartuar në gjuhën shqipe dhe në pesë ekzemplarë origjinalë.

Hartuar në Tiranë, më 18.03.2000

Nënshkruesit

Baki BERBERI



Peri BUZALLI

